



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR



RAPORTI VJETOR MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR
PËR VITIN 2018

Shkurt 2019

HYRJE

Raporti vjetor i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për vitin 2018 mbi gjendjen e kriminalitetit hartohet në përmbushje të detyrimit të parashikuar nga neni 50/2 i ligjit nr. 97/2016, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”¹, si dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.26, datë 12.02.2019, “Për përmbajtjen e raportit vjetor të drejtuesit të prokurorisë, për vitin 2018” dhe paraqitet përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj. Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Veprimtaria e organit të prokurorisë bazohet në Kushtutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligjeve të tjera në fuqi. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.

Një rëndësi të veçantë në aktivitetin e prokurorisë dhe përcaktimin e objektivave institucionale të saj, kanë strategjia e Prokurorisë 2018-2020 dhe plani i saj i veprimit, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit Europian dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë me të cilët ndajmë qëllimin e përbashkët të luftës ndaj krimit dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

E nderuar Znj. Prokurore e Përgjithshme!

Së pari, ju shprehim falendërimet tona për mbështetjen, që i keni dhënë punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe vëmëndjen e treguar ndaj saj, mbështetje e cila na ka inkurajuar në përmbushjen e detyrimeve tona kushtetuese dhe ligjore.

Nepërmjet këtij raporti, do të pasqyrojmë në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar treguesit e punës për periudhën njëvjeçare, ku në tërësi vihet re një ngarkesë e cila në disa drejtime është

¹ Në nenin 50 të ligjit nr 97/2016, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë është parashikuar se: “1. Prokurori i Përgjithshëm mund të marrë periodikisht të dhëna dhe informacione nga prokuroritë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së tyre. 2. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm përgatisin, brenda muajit shkurt të çdo viti, raportin vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës dhe ia paraqesin Prokurorit të Përgjithshëm. Raporti publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme. 3. Drejtuesit e prokurorive janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave që përmbahen në raportin vjetor.”.

përballuar me sukses nga trupa e prokurorëve, të ndihmuar nga oficerët e policisë gjyqësore, në ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim si dhe kryerjes në tërësi të detyrimeve ligjore.

Sipas strukturës bashkëngjitur udhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.26, datë 12.02.2019, “Për përmbajtjen e raportit vjetor të drejtuesit të prokurorisë, për vitin 2018”, paraqesim të dhënat si më poshtë:

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE

1. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2018

- 1.1. Respektimi i të drejtave të njeriut**
- 1.2. Të miturit dhe grupet vunerabël, si të pandehur dhe viktime;**
- 1.3. Garantimi i pavarësisë së prokurorisë**
- 1.4. Lufta kundër Korrupsionit**
- 1.5. Lufta kundër lëndëve narkotike**
- 1.6. Bashkëpunimi ndërinstytucional**
- 1.7. Bashkëpunimi ndërkombëtar**
- 1.8. Prioritete të tjera**
- 1.9. Përdorimin e metodave special hetimore dhe hetimet proaktive;**
- 1.10. Informacion mbi zbatimin e udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.**
- 1.11. Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Planin e Veprimit në zbatim të saj.**
- 1.12. Informacion statistikor mbi çeshtjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që zgjidhen, Emërohen ose Ushtrjnë funksione Publike.**
- 1.13. Të dhënat për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policies gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit.**

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

- 2.1 Volumi i punës në hetim për vitin 2018**
- 2.2 Llojet e vendimmarrjeve.**
- 2.3 Krahasimi me vitin 2017.**
- 2.4 Raporti i çështjeve të përfunduara në vitet 2018 dhe 2017.**

2.5 Çështje të përfaqësuara në Gjykatë.

2.6 Çështje të dërguara në gjykim referuar numrit total të procedimeve të hetuara.

2.7 Masat e sigurimit.

III. TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË NË DY VITET E FUNDIT

3.1 Proçedime të rregjistruara

3.2 Çështje të përfunduara

3.3 Vendimmarrja e gjykatës

3.4 Çështje të mosfilluara

IV. TË DHËNA GJEOGRAFIKE DHE DEMOGRAFIKE

V. SHTRIRJA E KRIMINALITETIT SIPAS TERRITORIT

VI. KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

VII. TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË.

VIII. ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

IX. PROÇEDIMET PENALE NË GJYKIM

X. POLITIKA E DËNIMIT

XI. ÇESHTJE TE HETIMIT

XII. TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT E MITUR DHE TE DEMTUARIT

XIII. PASOJAT E VEPRAVE PENALE

XIV. KËRKESAT PENALE

XV. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

XVI. STRUKTURA ORGANIZATIVE

XVII. ADMINISTRIMI I TEKNOLOGJISE DHE INFORMACIONIT NE PROKURORI

XVIII. RAPORTI FINANCIAR

XIX. ÇËSHTJE TË TJERA ME RËNDËSI

XX. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2019

2. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2018

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka treguar qëndrueshmeri të lartë në ushtrimin e veprimtarisë së saj në luftën kundër kriminalitetit sipas drejtimeve dhe përparësive të përcaktuara në vendimin e Këshilli të Ministrave Nr. 203, datë 11.4.2018 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2018”, Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të Prokurorisë për vitin 2017”, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vendimin e datës 20.09.2018, si dhe udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nisur nga qëllimi i përbashkët në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e rëndit juridik, në përcaktimin e objektivave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër kanë patur ndikim të konsiderueshëm edhe rekomandimet e Komisionit Europian dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Në zbatim të akteve juridike të sipërpërmendura, në mënyrë të përmbledhur, po ju paraqesim drejtimit dhe përparësitë kryesore në luftën kundër kriminalitetit gjatë vitit 2018, në luftën kundër kriminalitetit, si më poshtë:

1.1. Respektimi i të drejtave të njeriut

Respektimi i të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka qënë një objektivat kryesor të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Në këtë drejtim vëmendje të madhe i është kushtuar respektimit të drejtave të viktimave, familjarëve, ose trashëgimtarëve ligjor të tyre, të drejtave të personave nën hetim, të pandehurve, të paraburgosurve dhe të dënuarve. Ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale, sollën për viktimat e veprave penale, të drejta për një pjesmarrje më të madhe në procedim, gjë e cila është reflektuar në punën e kryer.

Në kuadër të respektimit të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtës për informim, me rëndësi të veçantë ka qënë bërja e institucionit tonë të aksesueshëm për publikun e gjërë, median, qytetarët e Qarkut të Shkodres, si edhe për subjektet, që u derivojnë të drejta dhe detyrime gjatë ushtrimit të ndjekjes penale. Në këtë drejtim ka qënë e nevojshme miratimi i kuadrit normativ, i cili rregullon realizimin e kësaj të drejte. Drejtuesi i prokurorisë ka miratuar udhëzimin nr 33, datë 31.12.2018 “Për komunikimin publik dhe bashkëpunimin ndërinstytucional”. Qëllimi i këtij udhëzimi është rregullimi i mënyrës së komunikimit me

publikun, median për aktivitetin dhe punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, si dhe përcaktimi i qartë i detyrave të zyrës për shërbimet me publikun.

E drejta e publikut për informacion është balancuar me përgjegjësinë dhe kompetencat e prokurorisë në funksion të mbrojtjes së hetimit të veprave penale dhe mbrojtjes së sigurisë publike. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së jetës dhe sigurisë viktimave, informatorëve, dëshmitarëve, të drejtës së privatësisë, si dhe interesit të ruajtjes së fshehtësisë së hetimit kur tejkalon interesin e publikut, ose interesit të të pandehurit, kur tejkalon interesin e publikut.

Mëgjithatë konstatohet se gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre disa prej prokurorëve, apo oficerëve e policisë gjyqësore nuk respektojmë me rigorozitet aspektet procedurale penale, të cilat lidhen më zvarritjen e hetimeve në mënyrë të pajustificuar, përpilimin e akteve procedurale jo-cilësore, apo të paarsyetuara, mos respektimit e dispozitave lidhur me të drejtat e viktimës (mosidentifikimi i saktë i viktimës, mosplotësimi i deklaratës së dëmit, apo formularëve të tjerë), duke sjellë cenimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu verëhet se disa prej kërkesave të qytetarëve nuk marrin përgjigje, madje edhe kur ato janë të përsëritura.

1. 2. Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktima;

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është e angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për të zbatuar më tej politikën e antidiskriminimit, përmirësimin e gjendjes me të drejtat sociale, me fokus të veçantë te grupet vulnerabël dhe të miturit.

Të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël, ndaj edhe mbrojtja e tyre përbën një ndër objektivat strategjike më të rëndësishme të reformës në sistemin e drejtësisë penale. Garantimi i drejtësisë miqësore dhe realizimi i interesit më të lartë të fëmijës është qëllimi i ndryshimeve ligjore dhe synimi që kërkohet të realizohet.

Në këtë kuadër, reforma në drejtësi ka përmirësuar dukshëm legjislacionin penal lidhur me të drejtat e viktimës dhe të fëmijëve në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor për të miturit dhe gratë viktima të dhunës në familje. Ligji nr. 35/2017, i cili parashikon ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, synon ta përafrojë legjislacionin procedural penal me standardet më të mira ndërkombëtare të parashikuara nga instrumentet ndërkombëtare në të cilat shteti shqiptar bën pjesë dhe synon të aderojë, si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata e Drejtësisë, *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, etj., Këto ndryshime kanë përcaktuar konceptin e “viktimës” dhe “viktimës akuzuese”, duke shtuar figura të posaçme “viktimën e mitur” dhe “viktimën e abuzuar seksualisht apo subjekt të trafikimit”; si dhe duke dhënë dhe përkufizimet dhe rregullimet për

këto subjekte, duke plotësuar dhe të drejtat e tyre në përputhje me vendimin kuadër të 15 marsit 2001 mbi qëndrimin e viktimave në procedimet penale, zëvendësuar më tej nga direktiva 2012/29/BE..

Kuadri ligjor për të miturit është plotësuar me ligjin nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”, hyrë në fuqi me 1 janar 2018, i cili ka për qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit, integrimin social të tyre, rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të të miturve dëshmitarë dhe viktimat, parandalimin e viktimizimit dytë (riviktimizimit), parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur kërkon angazhim për rritjen e profesionalizmit të organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur. Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme.

Në nenin 68 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” është parashikuar detyrimi i prokurorisë për të garantuar shërbimet e nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm. Çdo Prokurori, sipas ligjit duhet të ketë në përbërje të saj të paktën një koordinator, të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.

Në bazë të këtyre parashikimeve, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është krijuar dhe funksionon “Seksioni për hetimin e veprave penale të kryera nga të miturit, krimet seksuale, veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit, veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes...”. Gjithashtu në strukturën e prokurorisë është parashikuar pozicioni i koordinatorit për viktimat.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka vlerësuar maksimalisht edhe fenomenin e dhunës në familje, duke u përpjekur maksimalisht për një trajtim më të mirë të rasteve të dhunës në familje.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 nga Këshilli i Ministrave në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, organi i prokurorisë është angazhuar në prioritetet e mëposhtme:

- Zbatimin e kuadrit të ri ligjor lidhur me drejtësinë për të mitur në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor, aplikimit të masave alternative të shmangies nga ndjekja penale. Nga të dhënat statistikore për vitin 2018 rezulton se janë regjistruar 36 procedime penale, ndaj 38 të pandehurve, nga të cilat 11 procedime penale dhe për 13 të pandehur janë aplikuar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale.

- Hetime të shpejta dhe respektim të të drejtave dhe garancive procedurale si në drejtim të të miturit në konflikt me ligjin, të mitur dëshmitar dhe viktimat të veprës penale. Nga të dhënat statistikore rezulton se gjykimi i drejtpërdrejtë vijon të mbetet një nga llojet e gjykimeve më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë. Organi i prokurorisë për vitin 2018 ka dërguar për gjykim 57 çështje (ku përfshihen çështjet e mbartura në gjykim), por në asnjërën prej tyre ka kërkuar që të gjykohen me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë. Për vitin 2018 është rekomanduar rritje e rasteve të kërkuara nga organi i prokurorisë për gjykimin e drejtpërdrejtë. Gjithashtu ka qenë prioritet hetimi i shpejtë i këtyre rasteve, por relatohet se sa ka qenë afati i hetimit të tyre.
- Përmirësimi i aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e çështjeve që lidhen me drejtësinë penale për të mitur. Me qëllim garantimin e të drejtave të të gjitha subjekteve të procedimit penal, me fokus të miturit dhe viktimat e dhunës në familje, si një garanci e shtuar lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përgjatë procesit penal, është e domosdoshme që këto ndryshime të rëndësishme ligjore të njihen dhe të zbatohen nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët. Është e nevojshme rritja e profesionalizmit nëpërmjet trajnimeve specifike dhe përmbushja e detyrimeve ligjore prej tyre nëpërmjet zbatimit korrekt të ligjit.
- Hetime të shpejta, efektive dhe ashpërsim të politikës së dënimit për veprat penale të dhunës në familje. Nga të dhënat statistikore për vitin 2018 konstatohet se për vitin 2018 në lidhje me veprën penale, “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, janë regjistruar 92 çështje penale me 85 persona në hetim. Për këto çështje janë marrë në cilësinë e të pandehurit **57** persona. Rezulton se janë dërguar për gjykim 55 çështje për këtë vepër penale, me total prej 57 të pandehurish. Lidhur me politikën e dënimit, të ndjekur gjatë gjykimit, në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria, vetëm për 6 të pandehur është kërkuar dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës i dispozitës. Ndërsa për 15 të pandehur është kërkuar dënimi mesatar. Për 4 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit. Ndërkohë, që për vitin 2018 është rekomanduar ashpërsim i politikës së dënimit për rastet e dhunës në familje.
- Zbatimi me sukses dhe arritja e qëllimit të ndryshimeve ligjore, kërkojnë si angazhimin personal të çdo prokurori, angazhimin institucional, bashkëpunimin me aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut ashtu edhe rritjen e kapaciteteve njerëzore në prokurori.
- Gjithashtu, vlerë të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të drejtat në kuadër të procesit penal, garantimin e një procesi që mbron interesin më të lartë të të miturit marrin trajnimet dhe tryezat e përbashkëta me gjithë aktorët e përfshirë në sistemin penal.

Sa i përket ndjekjes penale të veprave penale ndaj fëmijëve e familjes në vitin 2018, treguesit statistikorë tregojnë se janë regjistruar 109 procedime penale për vepra kundër fëmijëve martesës dhe familjes, dhe 65 procedime penale janë dërguar për gjykim.

Dhuna në familje zë peshën më të lartë të procedimeve në këtë grup veprash, rreth 89 %, e konkretisht 92 procedime penale të regjistruara. Prokuroria ka hetuar me shpejtësi e përparësi këtë vepër penale ku konstatohet se 55 procedime penale janë dërguar në gjykatë.

Sa i përket keqtrajtimit të të miturve, nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 8 herë e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturit”, në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, ku janë regjistruar 8 procedime penale dhe janë dërguar 2 procedime penale për gjykim. Ndërsa në vitin 2017 është regjistruar vetëm 1 procedim penal.

1.3 Garantimi i pavarësisë së prokurorisë

Qëllimi i kuadrit të ri ligjor, në frymën e reformimit të sistemit të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës, është krijimi i një sistemi drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe eficient, sistem i cili duhet të jetë në gjendje të japë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe të zbatojë legjislacionin e përafuar me Acquis të BE-së.²

Prokuroria funksionon si një organ i decentralizuar duke garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj, nëpërmjet respektimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale, në përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe në plotësimin e funksioneve të tjera të dhëna me ligj. Kuadri i ri ligjor garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoriteti publik a privat.

Prokurori është përgjegjës për çështjen që i ngarkohet dhe i pavarur në punën e tij, me detyrimin në çdo rast të ndjekë udhëzimet e natyrës së përgjithshme të prokurorëve më të lartë, me qëllim unifikimin e qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara, bazuar edhe në rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 në drejtim të garantimit të pavarësisë së prokurorit nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër janë ndërmarrë masat e mëposhtme:

- i. Drejtuesi i prokurorisë ka miratuar udhëzimet nr 7, datë 16.07.2018 “Për mënyrën e informimit të drejtuesit të prokurorisë nga prokurori i gatshëm, zëvendësdrejtuesi i

² Shih vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 203, datë 11.4.2018 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2018”

prokurorisë, si dhe drejtuesi i seksionit”, si dhe nr 27, datë 04.12.2018 “Për mënyrën e informimit të drejtuesit të prokurorisë”.

- ii. Drejtuesi i prokurorisë ka miratuar urdhra me qëllim rregullimin e organizimit të brendshëm dhe të shpërndarjes së çështjeve, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 97/2016;
- iii. Marrjen e masave për respektimin e standardeve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve. Një nga aspektet më të rëndësishme, në këtë drejtim ka qënë miratimi nga drejtuesi i prokurorisë i udhëzimit nr 33, datë 31.12.2018 “Për komunikimin publik dhe bashkëpunimin ndërinstytucional”.
- iv. Marrjen e masave për rritjen profesionale, me qëllim njohjen dhe zbatimin e drejtë të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, si dhe për specializimin e prokurorëve në funksion të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit penal për të miturit, të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. **Prokurorët e kësaj prokurorie, në përsosjen e njohurive dhe dijeve të tyre, janë treguar vazhdimisht të angazhuar me pjesmarrjen e tyre në Programin e Trajnimit Vazhdues, program ky i mundësuar nga Shkolla e Magjistraturës. Do të dëshironim që edhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve, t’u ofroheshin po të njëjtat mundësi trajnimi, duke e parë si një domosdoshmëri për efikasitetin në hetim.**
- v. Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë. Në 5 procedime organi i prokurorisë ka filluar procedime penale kryesisht.

Masat e sipërpërmenduar janë rezultat i konsultimit me të gjithë prokurorët, të cilët kanë shfaqur mendimin e tyre në të mbledhjen e prokurorëve.

1.4 Lufta kundër Korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit, sidomos korrupsionit të funksionarëve publik dhe sekuestrimi e konfiskimi i të ardhurave me origjinë kriminale, aseteve kriminale apo pasurisë së pajustificuar të vënë nga korrupsioni zyrtar, është një nga prioritetet kryesore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, i cili përbën njëkohësisht edhe një nga kriteret që kushtëzon integrimin evropian të vendit tonë.

Objektivat kryesorë të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020, në kuadër të luftës kundër korrupsionit janë: përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit; rritja e numrit të operacioneve ku përdoren teknika speciale të hetimit; rritja e hetimeve proaktive dhe rritja e kapaciteteve të strukturave të organeve ligjzbatuese; përdorimi dhe menaxhimi më i mirë i informacionit për hetimin e korrupsionit; forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit; garantimi i qëndrueshmërisë së oficerëve të policisë gjyqësore (OPGJ) dhe

zyrtarëve të organeve ligjzbatuese; rritja e bashkëpunimit dhe e zhvillimit të takimeve dhe analizave me njësitë e përbashkëta hetimore (NJPH).

Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave ka qenë prioritet në ushtrimin e funksioneve, përgjatë vitit 2018. Rol të posaçëm në këtë drejtim ka pasur Njësia e Përbashkët Hetimore e cila me ndryshimet e reja, u strukturua në formën e një Seksioni me emërtimin: **Seksioni për Krimin Ekonomiko-Financiar, korrupsionit dhe krimin kompjuterik.**

Me qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe zbatimit të rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 të Këshillit i Ministrave janë ndërmarrë masat e mëposhtme:

- Rritje të hetimeve proaktive dhe teknikave speciale të hetimit. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka kryer hetime proaktive në kuadër të 21 procedimeve penal për veprën penale të korrupsionit të funksionarëve publik në nivel lokal. Rezulton se janë dërguar për gjykim 2 çështje për këtë vepër penale, me total prej 2 të pandehurish.
- Kryerja e hetimeve sistematike pasurore dhe rritje e numrit të asetëve të sekuestruara që prej fazës fillestare të hetimit dhe konfiskimin e tyre në përfundim; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në dy procedime penale lidhur me hetimet financiare të kryera për veprat penale në fushën e korrupsionit, përgjatë vitit 2018. Ndërsa, nga të dhënat statistikore rezulton se nga totali i çështjeve të filluara kryesisht për pastrimin e parave janë 2. Pra mbetet një numër i vogël hetimesh pasurore që lidhen me veprën penale të korrupsionit, ndërkohë që për vitin 2018 është rekomanduar rritje e numrit të hetimeve proaktive dhe rritje e numrit dhe të cilësisë së hetimeve sidomos të rasteve të zyrtarëve të lartë publikë.
- Hetime të shpejta dhe bashkëpunim me agjencitë e tjera. Këtu duhet theksuar bashkëpunimi shumë efektiv me Drejtorinë Vendore të SHISH
- Përmirësimi i cilësisë së hetimeve të kryera me qëllim rritjen jo vetëm të personave të dërguar për gjykim por edhe rritje të personave të dënuar me vendim të formës së prerë.
- Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit. Është theksuar ashpërsimi i politikës penale për këtë kategori veprash penale, duke e pasqyruar në faktin se 80% janë kërkesë për arrest në burg; si dhe 100 % janë kërkesë për dënim me burgim;
- Forcim të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Trajnime të oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët janë një hallkë shumë e rëndësishme e hetimeve. Janë paraqitur statistika në lidhje me trajnimet vazhduese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës me objekt luftën kundër korrupsionit dhe numrin e prokurorëve pjesëmarrës në to, por mungojnë trajnimet për trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore.
- Rritja e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore. Lidhur me aksesin në bazat e të dhënave kombëtare dhe ndërlidhjes së sistemeve kompjuterike, është realizuar ndërlidhja me baza të dhënash shtetërore si tatimet, QKR, QKL, gjëndjen civile,

pasuritë e paluajtshme, duke e bërë të mundur për akses për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore.

Volumi në hetim, ka qenë më i lartë krahasuar me atë të një viti të kaluar. Vërehet se janë ulur mosfillimet e procedimeve penale, duke u rritur numri i regjistrimit të procedimeve penale. Kanë përfunduar 20% e çështjeve duke u mbetur ende në hetim dhe verifikim 80 % nga ngarkesa totale që kanë pasur prokurorët përgjatë vitit 2018.

Këtë vit, ka pasur një rritje të ndjeshme të veprave penale kundër korrupsionit, fakt i cili bashkëshoqërohet edhe me një rritje të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim dhe të të pandehurve të akuzuar e dërguar në gjykim për këtë aktivitet kriminal. Sërish nga ana jonë, ekziston angazhimi, që kryesisht të marrim dijeni për këto lloj veprash penale dhe të mundësojmë një bashkëpunim më të frytshëm me aktorët e tjerë, institucione apo ndërgjegjësimin e qytetarëve për denoncimin e rasteve.

Për vitin 2018 i është dhënë prioritet kallëzimeve penale të paraqitura nga ILDKPKI-ja, për 6 mujorin e parë të vitit 2018 janë regjistruar të gjitha rastet e kallëzuara -3 raste. Për veprën penale të “refuzimit për deklarin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe i nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin”, e cila është vepër penale që referohet nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, numri i kallëzimeve penale të regjistruara për vitin 2018 është 3, po aq edhe numri i procedimeve penale të regjistruara.

Sa më sipër nga të dhënat statistikore të vitit 2018 për veprat penale në fushën e korrupsionit evidentohet një tendencë në rritje e numrit të çështjeve të regjistruara, të dërguara për gjykim dhe numrit të personave të dënuar. Megjithatë, numri i çështjeve të dërguara për gjykim dhe i të dënuarve mbetet ende i vogël. Në vitin 2018 vendin kryesor e zë vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, 80 çështje. Pra, konstatohet një ulje prej 5 çështjesh krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara, kryesisht në 2017-ën, ku kanë qenë regjistruar 85 çështje për vepra penal, ndërkohë që për vitin 2018 është rekomanduar forcimi i rolit aktiv të prokurorit, sidomos në drejtim të rritjes të numrit të hetimeve proaktive.

1.5 Lufta kundër lëndëve narkotike

Në zbatim të rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 të Këshillit i Ministrave, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është angazhuar maksimalisht në luftën kundër lëndëve narkotike. Treguesit në lidhje me veprat penale, që lidhen me faktet e kundraligjshme që si objekt material kanë lëndët narkotike kanë pësuar një rënie të lehtë, jo në regjistrimin e çështjeve por në dërgimin e tyre për gjykim. Kjo shpesh ka të bëjë me faktin se

referohen përdoruesit e lëndës narkotike dhe ende nuk ekziston një përqëndrim më i madh nga policia gjyqësore, për evidentimin në një shkallë më të gjerë të personave janë të angazhuar me prodhimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope. Përsa i përket kultivimit të lëndë snarkotike, konstatohet se ky tregues ka pësuar rënie.

1.6 Bashkëpunimi ndërinstytucional

Në zbatim të rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 të Këshillit i Ministrave, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka pasur parasysh mënyrën se si iniciohen hetimet, vijueshmërinë e tyre, një rol të veçantë në përmbushjen e funksioneve tona, e ka policia gjyqësore e shërbimeve. Qarku i Shkodres, me një shtrirje të madhe gjeografike, ka konstatuar angazhimin e policisë gjyqësore për zbulimin e veprave penale dhe raportimin e tyre, megjithëse për shkak të funksionimit të policisë gjyqësore, kemi hasur pengesa në përfundimin në një kohë sa më të shpejtë të hetimit. Policia gjyqësore është fakt që angazhohet edhe me kryerje detyrash të tjera përveç hetimit, gjë që çon drejt mbingarkesës së policisë gjyqësore të seksioneve dhe ngadalësimin në hetime.

Kemi pritshmëri për një angazhim maksimal edhe nga organe të tjera për njoftimin e fakteve penale për të cilat vihen në dijeni, kryesisht organet tatimore dhe doganore. Funksionin e tyre, përpiqet ta marrë shpesh herë përsipër policia e shtetit por ky fakt krijon shpesh pengesa proceduriale, dhe rritje fiktive të rregjistrimeve të materiale në prokurori, pasi nuk ezaurohen hallkat administrative, sipas ligjeve përkatëse që rregullojnë këto fusha specifike.

Në lidhje me institucionet e tjera si Gjykatën, Ministrinë e Drejtësisë etj, bashkëpunimi ka qenë i frytshëm dhe korrekt.

1.7 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Pasur parasysh lirinë e lëvizjes është tashmë një fakt i njohur që provat apo të dhënat mbi veprat penale mund të gjenden në shtete të ndryshme. Për këtë shkak ka ekzistuar një bashkëpunim i mirë me shtetet e huaja si në ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike të dërguara prej tyre, pranë institucionit tonë ashtu edhe të letër porosive të përcjella prej nesh, apo transferimit të procedimeve penale.

Rol të veçantë i është kushtuar ekstradimeve, urdhërave të kërkimit ndërkombëtar, duke marrë të gjitha masat e duhura për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe parimin e reciprocitetit.

1.8 Prioritete të tjera

Fakt problematik vazhdojnë të mbeten konfliktet e pronësisë, që çojnë në kryerjen e veprave penale të falsifikimit apo të shpërdorimit të detyrës nga funksionarët përkatës. Shkatërrimi i pronës apo vjedhjet vazhdojnë të kenë një peshë të madhe në raportin e përgjithshëm të veprave penale të ndodhura në këtë qark.

Lufta kundër këtyre veprave penale, nuk mund të zhvillohet e vetme, pasi ndikojnë kryesisht faktorët socialë, në rastin e vjedhjes së pasurisë.

Megjithatë angazhimi nga ana jonë ka qenë maksimal për të vënë në një kohë sa më të shkurtër, para drejtësisë, personat përgjegjës. Jemi angazhuar maksimalisht për të mundësuar gjykimet e drejtëpërdrejta, me qëllim kufizimin e shpenzimeve proceduriale dhe dhënien e drejtësisë në një kohë sa më të shkurtër.

1.9 Përdorimin e metodave special hetimore dhe hetimet proaktive;

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2018 në drejtim të përdorimit të metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër janë përdorur metoda speciale të hetimit në një numër të lartë procedimesh penale, kryesisht në hetimet për veprat penale të korrupsionit, mbajtje dhe shitje të lëndëve narkotike, krimet kundër jetës, dhënies së ndihmës për dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit etj. Ku janë kryer një numër i konsiderueshëm përgjimesh telefonike, ambientale, vëzhgimesh, si dhe në disa raste është aplikuar blerja e simuluar.

Përdorimi i këtyre metodave special të hetimit ka qënë shumë i suksesshëm në disa procedime penale, duke sjellë edhe arrestimit e një numri të konsiderueshëm personash.

1.10 Informacion mbi zbatimin e udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm

Në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë kam përgjegjësinë funksionale për të marrë të gjitha masat e nevojshme për organizimin e punës dhe mirëfunksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Gjithashtu kam përgjegjësinë për të garantuar zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.³

Informacioni duhet të jetë si për treguesit statistikor dhe analitik, ashtu edhe shpjegime të qarta mbi angazhimet tona, arritjet dhe problematikat në zbatim të akteve normative të mëposhtme:

³ Shih nenin 42, shkronjat “a” dhe “g” të ligjit nr 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

- I. Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 4 datë 26.10.2018 “Për përgjimet”.
- II. Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 3 datë 26.10.2018 “Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror”.
- III. Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 5 datë 26.10.2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”.
- IV. Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 6 datë 20.11.2018 “Për hetimin pasuror, sekuestrimin, dhe konfiskimin e produkteve të vepres penale”.

Në kuadër të njohjes të prokurorëve, oficerëve e policisë gjyqësore, apo punonjësve të administratës me këto udhëzime të përgjithshme janë përdorur dy mënyra të ndërthurura më njëra tjetren. Së pari atyre u është dërguar një kopje e secilit udhëzim, kundrejt nënshkrimit në zyrën e tyre nga sekretarja në prokurori. Së dyti këto udhëzime janë analizuar dhe diskutuar në mbledhjen e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Drejtuesi i prokurorisë me urdhërin nr 3 datë 30.01.2019 “Për verifikimin e zbatimit të udhëzimeve të prokurorit të përgjithshme” ka verifikuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme. Nga ky verifikim rezultuan disa problematika, të cilat do të ndërthuren me analizën e mëposhtme.

Në vijim do ju paraqesim të gjitha masat e marra për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të sipërcituara.

- I. Masat e marra në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 4 datë 26.10.2018 “Për përgjimet”. Në regjistrin e përgjimeve, për mbajtjen e të cilit me urdhër të drejtuesit të prokurorisë është caktuar zëvendësdrejtuesi i prokurorisë, shënohen aktet që urdhërojnë, autorizojnë, vleftësojnë, ose zgjasin përgjimet, si dhe fillimin e mbarimin e veprimeve të çdo përgjimi.⁴ Gjatë verifikimit të zbatimit nga prokurorët verëhet se disa prej tyre nuk i paraqesin aktet procedurale të përmendura më lart tek zëvendësdrejtuesi.

Nga ana e drejtuesit të prokurorisë me anë të urdhërit nr datë 20.12.2018 “Për disa shtesa në Urdhërin nr 2 datë 29.06.2018 “Për detyrat funksionale të punonjësve të administratës” janë reflektuar në këtë të fundit parashikimet e udhëzimit të përgjithshëm.

Në nenin 9 të këtij udhëzimi është parashikuar se procesverbali i transkriptimit përpilohet nga oficeri i policisë gjyqësore i specializuar i Strukturës së Përgjimit të Komunikimeve Elektronike. Rezulton se ky parashikim nuk zbatohet në të gjitha rastet, duke bërë që transkriptimi të kryhet nga oficeret pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër. Gjithashtu rezulton se procesverbalet dhe regjistrimet nuk i dorëzohen menjëherë prokurorit dhe brenda 5 diteve nuk depozitohen në sekretari. Nuk shënohet në regjistër, kundrejt nënshkrimit personi që është njohur me aktin, si dhe nuk përpilohet deklarata për ruajtjen e sekretit dhe ndalimi i publikimit. Në

⁴ Shih nenin 5/7 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 4 datë 26.10.2018 “Për përgjimet”.

përgjithësi të gjitha rregullat për ruajtjen e sekretit të përgjimit respektohen nga sekretaria, prokurorët dhe oficeret e policisë gjyqësore.

Në nenin 12/5 të udhëzimit parashikohet se në çdo rast asgjësimi i materialit të përgjimit kryhet në prani të një gjyqtari ose të një personi tjetër të autorizuar për këtë qëllim. Këta të fundit e vertetojnë këtë fakt me procesverbalin e asgjësimit. Ky parashikim rezultoi se nuk është zbatuar nga ana e prokurorëve.

Në kuadër të problematikave të konstatuara nga verifikimi i zbatimit të udhëzimit, pas evidentimit, është thirrur mbjedhja e prokurorëve, në të cilën kanë qënë prezent edhe oficeret e policisë gjyqësore. Aty u është terhequr vëmendja për mangësitë e konstatuara. Gjithashtu në mënyrë periodike do të bëhet verifikimi i zbatimit të udhëzimit.

- II. Masat e marra në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 3 datë 26.10.2018 “Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror”. Në zbatim të nenit 8 të këtij udhëzimi të gjithë prokurorët, oficeret e policisë gjyqësore, si dhe punonjësit e administratës kanë plotësuar formularin përkatës për pajisjen me certifikatë sigurie.

Nga ana e drejtuesit të prokurorisë me anë të urdhërit nr datë 20.12.2018 “Për disa shtesa në Urdhërin nr 2 datë 29.06.2018 “Për detyrat funksionale të punonjësve të administratës” janë reflektuar në këtë të fundit parashikimet e udhëzimit të përgjithshëm.

Me urdhër të drejtuesit të prokurorisë është caktuar zëvendësdrejtuesi i prokurorisë, personi përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, regjistrimit të shumfishimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, librit të qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, librit të dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, librit të regjistrimit të regjistrave për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror “ sipas modelit bashkelidhur urdherit nr. 165 datë 24.07.2017.

Veprimet me dokumentat e klasifikuara që hyjnë në institucion, të përshkruara në nenin 3, 5 6 të udhëzimit të përgjithshëm, nga verifikimi rezultoi se zbatohen pothuajse plotësisht, kjo edhe për shkak se parashikimet e bërë në urdhërin Urdhërin nr datë 29.06.2018 “Për detyrat funksionale të punonjësve të administratës” kanë qënë në përputhje me parashikimet e mëvonshme të udhëzimit të përgjithshëm.

- III. Masat e marra në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 6 datë 20.11.2018 “Për hetimin pasuror, sekuestrimin, dhe konfiskimin e produkteve të vepres penale”. Në nenin 3 të këtij udhëzimi kërkohet që prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, sipas rastit menjëherë, por jo më vonë se brenda një muaji nga hyrja në fuqi duhet të kalojnë kopje të akteve përkatës, ose të dërgojnë informacion në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë në lidhje me subjektet që kanë

patur në hetim dhe/ose kanë përfunduar hetimet, si në rastet kur janë dërguar për gjykim, ashtu edhe në rastet kur është vendosur pushimi i hetimeve për veprat penale të parashikuara në nenin 7 të këyij udhëzimi. Për zbatimin e këtij parashikimi është urdhëruar nga drejtuesi i prokurorisë prokurori i seksionit të ekzekutimit të vendimeve penale Z. Agron Bushati për evidentimin e çeshtjeve penale të përfunduara me vendim gjyqësor të shkallës së parë ose të pushuara nga organi i prokurorisë, dhe për dërgimin e informacionit të sipërpërmendur në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë. Gjithashtu drejtuesi i prokurorisë ka urdhëruar të gjithë prokurorët, të cilët kanë patur në hetim dhe ose kanë përfunduar hetimet dhe i janë drejtuar me kërkesë përkatëse gjykatës, të dërgojnë informacionin përkatës në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë.

IV. Masat e marra në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 5 datë 26.10.2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”. Në këtë udhëzim të përgjithshëm është përcaktuar qartë roli që duhet të ketë drejtuesi i prokurorisë. Për realizimin e këtij roli, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka marrë masat e mëposhtme:

- Përfshirjen në strukturën e prokurorisë të seksionit për të mitur.
- Përfshirjen në strukturën e prokurorisë, në seksionin për të miturit e koordinatorit të asistencës ndaj viktimave të vepres penale.
- Propozimi tek Prokurori i Përgjithshëm për ndryshime në buxhet dhe personel për të garantuar asistencën ndaj viktimave sipas specifikave të prokurorisë.

Në zbatim të nenit 24 të udhëzimit të përgjithshëm, për të garantuar të drejtën për informim dhe njoftim në ambjentet e prokurorisë, në vende të dukshme dhe të aksesueshme nga publiku janë afishuar të drejtat e viktimës të vepres penale. Gjithashtu janë përgatitur broshura informuese, të cilat u jepen nga punonësi i shërbimit të prokurorisë, ose oficeri i policisë gjyqësore, viktimave të vepres penale.

Në kuadër të masave kundër viktimizimit sekondar është krijuar një ambjent i veçantë në institucion për marrjen e dëshmisë së viktimave, në veçanti atyre të mitur.

Gjatë verifikimit të zbatimit të këtij udhëzimi rezulton se nuk bëhet në mënyrë të saktë identifikimi i viktimave. Në asnjë rast nuk është bërë përcaktimi i faktit nëse viktima ka pësuar dëm, ose të jetë plotësuar deklaratat e dëmit. Gjithashtu rezulton se seksioni për të mitur nuk harton raporte periodike dhe tematike, që i dërgohen drejtorisë përgjegjëse për asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në kuadër të problematikave të konstatuara nga verifikimi i zbatimit të udhëzimit, pas evidentimit, është thirrur mbjedhja e prokurorëve, në të cilën kanë qënë prezent edhe oficeret e policisë gjyqësore. Aty u është terhequr vëmendja për mangësitë e konstatuara. Gjithashtu në mënyrë periodike do të bëhet verifikimi i zbatimit të udhëzimit.

Drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë udhëzime të përgjithshme në zbatim të ligjit, ose në zbatim të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Për sa kërkohet ju informojnë se nga ana e drejtuesit të prokurorisë janë nxjerrë aktet e mëposhtme:

- Urdhër nr. 2 datë 29.06.2018 “ Për detyrat funksionale të punonjësve të administrates ”
- Urdhër nr 23 datë 30.10.2018 “ Për kordinimin e punës në kryesekretari për mbajtjen e regjistrave manual dhe elektronike”
- Urdhër nr.26, datë 07.11.2018 “Për miratimin e kodit të etikës dhe mirësjelljes për oficerët e policisë gjyqësore dhe personelin e administratës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”
- Udhëzim nr 27, datë 04.12.2018 “Për mënyrën e informimit të drejtuesit të prokurorisë.
- Udhëzim nr 7, datë 16.07.2018 “Për mënyrën e informimit të drejtuesit të prokurorisë nga prokurori i gatshëm, zëvendësdrejtuesi i prokurorisë, si dhe drejtuesi i seksionit.
- Urdhër nr.20, date 26.10.2018 “Për riorganizmin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”
- Urdhër nr. 3 datë 02.07.2018 “ Për delegimin e firmës ”
- Urdhër nr 19 datë 23.10.2018 “ Për funksionimin e arkivës”
- Udhëzim nr 33, datë 31.12.2018 “Për komunikimin publik dhe bashkëpunimin ndërinstitucional”.
- Urdhër nr.32 datë 31.12.2018 “Për administrimin e materialeve të kallëzimeve dhe të fashikujve të procedimeve penale”

Në zbatim të kompetencave në ushtrimin e ndjekjes penale drejtuesi i prokurorisë ka kërkuar informacion për ecurinë e procedimeve me urdhërat nr 6, datë 11.07.2018 dhe nr 2 datë 30.01.2019 “Për verifikimin e ecurisë të çështjeve gjatë hetimeve paraprake”. Në zbatim të këtyre urdhërave prokurorët kanë përpiluar informacionin përkatës.

Nga ana e drejtuesit të prokurorisë janë nxjerrë dy udhëzime jo të detyrueshme për dy çështje konkrete. Në të dy rastet prokurori, duke mos njoftuar drejtuesin për vendimmarrjen, paraqet fashikujt e procedimit penal (të përfunduar), për siglim tek drejtuesi. Ky i fundit ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshëm, të cilat nuk janë ndjekur nga ana e prokurorit të çështjes.

1.11 Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Planin e Veprimit në zbatim të saj⁵

⁵ Shih vendimin datë 20.09.2018 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që ka miratuar Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të Prokurorisë për vitin 2017.”

Nga prokurori janë paraqitur **kërkesa për caktim mase shtrënguese** ndërkohë që **gjykata ka vendosur për to në në të gjitha rastet**.


- Prokurori ka kërkuar caktimin e **masës së sigurimit me arrest** në **167 raste** dhe nga **gjykata është caktuar kjo masë** në **129 raste** dhe në tre raste arrest burg me afat.
- Nga prokurori është kërkuar në **4 raste caktimi i masës së sigurimit arrest ne shtëpi** ndërkohë që **gjykata e ka caktuar këtë masë sigurimi** në **19 raste**.
- Nga prokurori është kërkuar në **75 raste caktimi i masës së sigurimit detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore n. 234 i K.Pr.Penale** ndërkohë që **gjykata e ka caktuar këtë masë sigurimi** në **85 raste**.

Viti 2018

Kerkesat e prokurorit



Vendimet e gjykes






Raporti i kërkesave me vendimet gjyqesore:

Kërkesat e prokurorit/ vendimet e gjykatës :

Prokuroria

Gjykata



XV. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

I. Ekstradime

a) Ekstradime nga jashtë


Gjatë vitit 2018 janë paraqitur gjithsej 5 kërkesa ekstradimi për shtetasit shqiptarë apo të huaj, të cilët janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shteteve të tjera pasi janë shpallur në kërkim ndërkombëtar mbi bazën e një vendimi penal dënimi të formës së prerë ose vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” të dhënë nga Gjykatat shqiptare.

Krahasuar me vitin 2017, gjatë vitit 2018 vërehet rritje e numrit të kërkesave të paraqitura nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e shtetasve nga jashtë në masën 48 %, për shkak se

gjatë kësaj periudhe është rritur numri i shtetasve shqiptarë të arrestuar nga autoritetet e huaja.


Më poshtë paraqesim në formë tabelare dhe grafike të dhënat për periudhën 2017-2018:

	Viti 2017	Viti 2018
Nr. kërkesave për ekstradim	2	5



Nga të dhënat statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2018, numri më i madh i kërkesave për ekstradim nga jashtë shtetit janë bërë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, prej 3 kërkesash, ndërsa 2 kërkesa për krime kundër autoritetit të shtetit. Disponimi për pranim është bërë në 4 raste.

Në grafik kërkesat për ekstradim sipas veprave, për vitin 2018 paraqiten në këtë mënyrë:




b) Ekstradime për jashtë

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur gjithsej 8 kërkesa ekstradimi për shtetasit shqiptarë apo të huaj, të cilët janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shtetit tonë pasi janë shpallur në kërkim ndërkombëtar mbi bazën e një vendimi penal dënimi të formës së prerë ose vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” të dhënë nga Gjykatat e vende të tjera.

Krahasuar me vitin 2017, gjatë vitit 2018 vërehet rritje e numrit të kërkesave të paraqitura nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e shtetasve nga jashtë në masën 15 %, për shkak se gjatë kësaj periudhe është rritur numri i shtetasve shqiptarë të arrestuar nga autoritetet e huaja.


Më poshtë paraqesim në formë tabelare dhe grafike të dhënat për periudhën 2017-2018:

	Viti 2017	Viti 2018
Nr. kërkesave për ekstradim	7	8



Nga të dhënat statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2018, numri më i madh i kërkesave për ekstradim nga jashtë shtetit janë bërë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, prej 3 kërkesash, ndërsa 3 kërkesa për krime kundër autoritetit të shtetit, 1 kërkesë për krime kundër personit, si dhe 1 kërkesë për vepra të kryera nga banda e armatosur. Disponimi për pranim është bërë në 6 raste.


Në grafik kërkesat për ekstradim sipas veprave, për vitin 2018 paraqiten në këtë mënyrë:




II. Letërporositë

a. Letërporositë nga jashtë

Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale të ardhura nga autoritetet e huaja, gjatë vitit 2018 janë transmetuar 56 letërporosi, tregues i cili rezulton me rritje në masën 40 % krahasuar me vitin 2017, vit në të cilin janë transmetuar 39 letërporosi.




Nga të dhënat statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2018, numri më i madh i leterporosive nga jashtë shtetit janë bërë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, prej 31 kërkesash, ndërsa 14 kërkesa për krime kundër autoritetit të shtetit, 8 kërkesë për krime kundër personit, 2 kërkesë për vepra penale kundër drejtësisë, 1 për krime kundër mjedisit. Disponimi për pranim është bërë në 46 raste.




b. Letërporositë për jashtë

Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale dërguar autoriteteve të huaja, gjatë vitit 2018 janë transmetuar 51 leterporosi, tregues i cili rezulton me rritje në masën 1 % krahasuar me vitin 2017, vit në të cilin janë transmetuar 50 leterporosi.




Nga të dhënat statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2018, numri më i madh i leterporosive nga jashtë shtetit janë bërë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, prej 25 kërkesash, ndërsa 21 kërkesa për krime kundër autoritetit të shtetit, 5 kërkesë për krime kundër personit. Disponimi për pranim është bërë në 45 raste dhe 3 raste mospranim.



III. Njohjet e vendimeve penale

i. Njohjet e vendimeve penale të huaja

Referuar të dhënave statistikore rezulton se, për vitin 2018 autoritetet e huaja kanë paraqitur gjithsej 5 kërkesa për njohjen e vendimeve të tyre penale dhënë në ngarkim të shtetasve shqiptarë, tregues ky i cili rezulton me ulje në masën 23 % krahasuar me vitin 2017, në të cilin është kërkuar njohja e vendimeve penale në 7 raste.



Disponimi për pranim është bërë në 5 raste

IV. Urdhrat e arrestit ndërkombëtar

Referuar të dhënave statistikore konstatohet se gjatë vitit 2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 10 shtetas (shqiptarë apo të huaj) të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë ose ndaj tyre me vendim Gjykate është caktuar një masë sigurimi personal “Arrest në burg”, ku 3 prej tyre janë ekzekutuar. Ky tregues ka pësuar rritje në masën 31% krahasuar me vitin 2017, në të cilin janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 7 persona, ku janë 2 prej tyre janë ekzekutuar.

XVI. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Në vitin 2018, stafi i kësaj prokurorie, perbehet nga 43 punonjës. Numri i prokurorëve është 19, nga të cilët 13 meshkuj dhe 6 femra.

Puna e prokurorëve është ushtruar nën drejtimin e drejtuesit të kësaj prokurorie i cili ndihmohej nga 1 zëvendës drejtues si dhe drejtuesit e seksioneve.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 2 datë 19.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Udhëzimit nr. 3 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, nga drejtuesi i kësaj prokurorie, me Urdhëri nr 2 datë 16.01.2018 “Për ri- organizimin e seksioneve në Prokurinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”, u urdhërua krijimi i Seksioneve në varësi të objektit të punës, referuar veprave penale, si më poshtë vijon:

1. Seksioni për Krimin Ekonomiko-Financiar, korrupsionit.

2. Seksioni për hetimin e veprave penale të kryera nga të miturit, veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit, veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, veprat penale kundër drejtësisë.
3. Seksioni për hetimin e krimeve kundër jetës, veprat penale kundër shëndetit, veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës, veprat penale kundër lirisë së personit, mashtrimet, shkatërrimi i pronës, veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, veprat penale ushtarake.

Ky urdhër, u shfuqizua me urdhërin nr. 20, date 26.10.2018 “Për riorganizmin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër” duke sjellë ndryshimin e drejtuesit të Seksioneve.

Me anë të këtij të fundit u urdhërua krijimi i seksioneve në varësi të objektit të punës, referuar veprave penale, si më poshtë vijon:

1. Seksioni për Krimin Ekonomiko-Financiar, korrupsionit dhe krimin kompjuterik,
2. Seksioni për hetimin e veprave penale të kryera nga të miturit, krimet seksuale, veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit, veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, veprat penale kundër drejtësisë.
3. Seksioni për hetimin e krimeve kundër jetës, veprat penale kundër shëndetit, veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës, veprat penale kundër lirisë së personit, mashtrimet, shkatërrimi i pronës, veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, veprat penale ushtarake.
4. Seksioni për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.


U krijua seksioni për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, në përgjigje të ngarkesës së rritur nga vënia në funksionim të Insitucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shkodër.

Me urdhërin nr 24 datë 26.10.2018 “Për emërimin e zëvendës drejtuesit” është caktuar zëvendës drejtuesi i ri Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Tabelë organike numerike e prokurorisë

Drejtues	1	1	1	0
Zv/Drejtues	1	1	1	0

Prokurorë	17	17	11	6
Gjithsej	19	19	13	6



Përgjatë vitit 2018, prokurorët Esmeralda Ndoci, Sajmir Bahiti, Astrit Halilaj, janë komanduar me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, respektivisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Gjirokaster si dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.


Përgjatë vitit 2018 prokurorët Arben Smaçi dhe Marsida Frashëri me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 208/3 datë 09.01.2018 “Për riorganizimin e grupit të punës për hartimin e raportit në kuader të vleresimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivleresimit kalimtar”, janë caktuar në pozicionin e përkohshëm të magjistratit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në vitin 2018, është komanduar për të ushtruar funksionet, përgjatë këtij viti, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori Ajola Prenci dhe Olgert Rumnici.

Policia gjyqësore pranë kësaj Prokurorie, në përbërjen e saj ka pasur gjithsej 10 oficerë policie gjyqësore, nga të cilët 7 meshkuj dhe 3 femra.

Tabelë organike numerike e policisë gjyqësore


Numri	Organika	Meshkuj	Femra
OPGJ	10	7	3



Personeli administrativ vepron në mbështetje të prokurorëve dhe ndihmon në prodhimin, administrimin e të gjithë dokumentave apo në shërbime të tjera të domosdoshme për punën e tyre. Numri i përgjithshëm i personelit administrativ, duke përfshirë kryesekretaren, kryetaren e degës së buxhetit, spacialit –IT, sekretare si edhe punonjësit në shërbimet ndihmëse si shoferë, punonjës shërbimi, sanitare, ftues dhe mirembajtes, ne vitin 2018 ka qene 14, nga të cilët 8 femra dhe 6 meshkuj.

Tabele organike numerike e administratës

Funksioni	Organika	Meshkuj	Femra
K/Sekretare	1	0	1
K/Deges Buxhetit	1	0	1
Speciali -IT	1	1	0
Sekretare	5	1	4
Shofere	2	2	0
Ftues	1	1	0
Sanitare	1	0	1
Punonjes sherbimi	1	1	0
Mirembajtes	1	0	1
Gjithsej	14	6	8



Për vitin 2018:


Prokuroria, perbehej nga nje staf prej 43 punonjesish por pesoi ndryshime ne strukturen e saj. Konkretisht drejtuesi në muajin janar të vitit 2018, u vendos të ndihmohej nga 1 zëvendësdrejtues. Zëvendësdrejtuesi ushtron edhe funksionin e Drejtuesit të seksionit për Krimin Ekonomiko-Financiar, korrupsionit dhe krimin kompjuterik.

1	drejtues prokurorie
1	zv/drejtues
17	prokurore
10	oficere
1	kryesekretar
1	shef finance
4	sekretare prane prokurorit
1	sekretar
2	shofere
1	ftues
1	punonjes sherbimi
1	sanitare
1	mirembajtese

Tabelë organike numerike e prokurorisë


Funksioni	Organika	Meshkuj	Femra
Drejtues	1	1	0
Zv/Drejtues	1	1	0
Prokurorë	17	11	6

Gjithsej	19	13	6
----------	----	----	---



Tabelë organike numerike e policisë gjyqësore


Numri	Organika	Meshkuj	Femra
OPGJ	10	7	3



Tabele organike numerike e administratës

Funksioni	Organika	Meshkuj	Femra
K/Sekretare	1	0	1
K/Deges Buxhetit	1	0	1

Speciali -IT	1	1	0
Sekretare	5	1	4
Shofere	2	2	0
Ftues	1	1	0
Sanitare	1	0	1
Punonjes sherbimi	1	1	0
Mirembajtes	1	0	1
Gjithsej	14	6	8




A. Të dhëna për ngarkesën e punës së prokuroreve dhe oficerëve të policisë gjyqësore

Ngarkesa në punë e prokuroreve përsa i përket ceshjeve penale në hetim dhe mënyren e përfundimit të tyre për vitin 2018, (503 mosfillime dhe 2947 procedime penale, në të cilat 2214


janë të regjistruara rishtazi për vitin 2018, ndërsa 749 të mbartura) paraqiten si me poshte ne tabelen e detajuar (prokurori/mosfillime/procedime ne hetim ne vitin 2018, ku bëjnë pjesë të regjistruara ne vitin 2018, të mbartura, të rifilluara/shfuqizuara etj, dhe mënyra e perfundimit pushuar/pezulluar/transferuar/derguar gjyqit/procedime te bashkuara me procedime te tjera dhe procedimet e mbartura në hetim per vitin 2019).

Grafiku i meposhtem tregon ne % ngarkesen e prokuroreve per vitin 2018.

Prokuro r	Nr.Pr oc	Perfundu ar	Derg.Gj yq	Pezullu ar	Pushu ar	Derg.Ko mp.	Bashk.Pr oc	Ne Heti m
A.Bushat i	51	2	0	0	2	0	0	49
A.Halili	106	41	11	5	10	2	3	-
A.Murça j	98	64	36	7	17	3	3	34
A.Smaçi	34	16	5	5	3	0	1	-
A.Prençi	257	195	86	42	13	5	5	62
B.Hamza	178	142	60	16	37	2	0	39
E.Cufi	247	49	23	4	12	0	0	198
E.Lelçi	293	244	109	76	51	6	2	49
E.Ndoci	103	86	10	18	14	4	8	-
F.Laloshi	293	232	131	48	50	0	3	61
F.Lekani	207	149	101	6	40	1	1	57
L.Çarda ku	305	263	146	62	51	2	2	40
Sh.Milla	120	74	39	6	17	6	6	46
V.Staka	311	252	149	39	62	1	1	59
Xh.Lita	211	174	74	13	78	2	7	47
S.Bahiti	91	80	18	13	11	5	0	-
M.Frash eri	19	8	6	0	2	0	0	-
O.Rumni ci	13	0	0	0	0	0	2	-
Total	2947	2071	1004	360	470	39	44	702



Grafiku i meposhtem tregon ne % procedimet e mbartura ne vitin 2019, per çdo prokuror.




Në organikën e Prokuorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër janë gjithsej 10 oficer të policisë gjyqësore. Më poshtë paraqësim ngarkesën e secilit oficer të policisë gjyqësore për vitin 2018:

Nr.	Oficeri Pol.Gjyqësore	Totali I çeshtjeve
1	B.Vujoshi	15
2	D.Bilali	146
3	E.Myrtaj	98

4	E.Caku	39
5	K.Como	140
6	K.Livalli	190
7	N.Bajrakurti	180
8	S.Doda	134
9	S.Kerxhaliu	214
10	Fatmira Vata	35

Gjate vitit 2018, treguesit e pergjithshem te volumit te punes se kryer nga Oficeret e Policise Gjyqesore, te seksionit te prokurorisë, për procedimet e regjistruara ne vitin 2018 paraqiten si me poshte :



Nga të dhënat e pasqyruara në grafik rezulton se për 49 % të procedimeve të regjistruara të reja për vitin 2018 janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë, dhe 51 % e procedimeve të tjera të regjistruara të reja për vitin 2018 janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore të policisë së shtetit.

A. Masat e marra nga drejtuesi i prokurorisë.

Drejtuesi i prokurorisë në kuadër të garantimit të funksionit të prokurorisë ka ndërmarrë një seri masat për plotësimin e kuadrit nënligjor me objekt rregullimin dhe nomimin e punës së administratës së prokurorisë, me qëllim evidentimin e përgjegjësisë së secilit punonjës. Janë nxjerrë urdhërat e mëposhtëm:

- Urdhër nr. 2 datë 29.06.2018 “Për detyrat funksionale të punonjësve të administratës”. Qëllimi i këtij urdhëri është përcaktimin e rregullave dhe detyrave funksionale për secilin punonjës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për të garantuar përmbushjen e funksioneve administrative të prokurorisë, përfshirë mbajtjen e regjistrave dhe raporteve, mbajtjen e protokollit të dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe arkivit, administrimin

financiar dhe material, menaxhimin informatik, shqyrtimin e ankesave dhe detyra të tjera që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë

- Urdhër nr 23 datë 30.10.2018 “Për kordinimin e punës në kryesekretari për mbajtjen e regjistrave manual dhe elektronike”. Me anë të këtij urdhëri janë normuar detyrat dhe përgjegjësitë e kryesekretarës, sekretarës në kryesekretari, si dhe e punonjës së IT. Është përcaktuar procedura që duhet të ndjekin regjistrimi i materialeve në regjistrat elektronik dhe manual. Gjithashtu janë përcaktuar mekanizma kontrolli të punës në kryesekretari. Është caktuar një oficer i policisë gjyqësore, që në mëngjesin e çdo ditë pune, por jo më vonë se në orën 11:00, të mbikqyrë plotësimin me të dhënat përkatëse (të ditës paraardhëse, ose ato të përditësimit) të regjistrave manual dhe elektronik nga kryesekretari dhe punonjësi i IT. Në rastet e ngarkesave të mëdha ai asiston këta të fundit për plotësimin e të dhënave. Oficeri i policisë gjyqësore në përfundim të mbiqyrjes të njoftojë prokurorin e regjistrat për problematikat e vërejtura. Në fund të çdo muaji oficeri njofton, me anë të një relacioni, drejtuesin e prokurorisë për të dhënat e hedhura në regjistrat manual dhe elektronik dhe numrin fundor.
- Urdhër nr 19 datë 23.10.2018 “Për funksionimin e arkivës”. Objekti i këtij urdhëri është normimi i funksionimit të arkivës duke përcaktuar detyrat e arkivistës, aspektet procedurale të levizjes (hyrjeve dhe daljeve) matërialeve në arkive. Gjithashtu është bërë rregullimi mënyrës së koordinimit të punës me kryesekretarinë. Për shkak problematikave të konstatuara drejtuesi i prokurorisë ka urdhëruar me urdhërin nr 11 datë 23.07.2018 “Krijimi i grupit të punës për inventarizimin e arkivës”. Grupi i punës kishte si objekt të veprimtarisë së tij inventarizimin e arkivës për dosjeve të pushuara, mosfilluara, dërguar për gjykim për vitet 2013-2018, si dhe bërjen e rakordimeve përkatëse me regjistrat fizik, manual, elektronik dhe sistemin CAMS. Prokurori i regjistrat, në cilësinë e kryetarit të grupit të punës, ka qënë përgjegjës për kontrollin dhe kordinimin e punës të anëtarëve të grupit të punës. Kryesekretarja dhe punonjësi i IT kanë qënë përgjegjës për rakordimin e të dhënave që rezultojnë nga inventarizimi i arkivit me ato të regjistrat fizik të kallëzimit të veprave penale, mosfillimeve, të procedimeve penale, si dhe regjistrat manual, elektronik dhe sistemit CAMS. Arkivistja dhe dy oficer të policisë gjyqësore kanë qënë përgjegjës për inventarizimin fizik të dosjeve të pushuara, mosfilluara, dërguar për gjykim për vitet 2013-2018. Pas një pune disa mujore grupi i punës ka realizuar detyrën e tij.
- Urdhërin nr 28 datë 06.12.2018 “Për krijimin e grupit të punës për inventarizimin e provave material. Grupi i punës kishte objekt të veprimtarisë së tij inventarizimin e provave materiale, të cilat ndodhen në dhomen e provave, si dhe bërjen e rakordimeve përkatëse me regjistrin e provave materiale. Prokurori i ekzekutimeve në cilësinë e kryetarit të grupit të punës, ishte përgjegjës për kontrollin dhe kordinimin e punës të anëtarëve të grupit të punës. Arkivistja ishte përgjegjës për rakordimin e të dhënave që

rezultojnë nga inventarizimi i provave materiale me ato të regjistrit të provave materiale. Oficeri i policisë gjyqësore ishte përgjegjës për inventarizimin fizik të provave materiale. Bën rakordimin e provave materiale me procedimet penal, për llogari, të cilave janë sekuestruar. Nëse procedimet penale janë në hetim e sipër, ai duhet të komunikojë me prokurorin e çështjes për eventualitetin e vendimmarrjes. Ndërsa për procedimet penale, për të cilat është marrë një vendim përfundimtar, të rakordohet me prokurorin e ekzekutimit për ezaurimin e procedurës së ekzekutimit. Grupi i punës ka realizuar me efektivitet detyrën e ngarkuar.

- Urdhër nr.32 datë 31.12.2018 “Për administrimin e materialeve të kallëzimeve dhe të fashikujve të procedimeve penale”. Qëllimi i këtij urdhëri është normimi i levizjes së materialeve të kallëzimeve penale dhe procedimeve penale në prokurori. Janë përcaktuar aspektet procedurale dhe detyrat e punonësve në kontakt me këto material. Janë përpilur regjistrat specifike për dokumentimin e levizjës së materialeve të kallëzimeve dhe procedimeve penale në prokurori.
- Urdhër nr.26, datë 07.11.2018 “Për miratimin e kodit të etikës dhe mirësjelljes për oficerët e policisë gjyqësore dhe personelin e administratës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”. Ky kod përcakton parimet dhe normat e mirësjelljes, të cilat duhet të respektohen nga oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të funksionit të tyre, për të siguruar dhe garantuar profesionalizëm, paanshmëri, ndershmëri, integritet dhe korrektësi në ushtrimin e funksioneve të tyre, për të përmirësuar dhe rritur marrëdhëniet institucionale dhe ndërinstucionale, duke shmangur konfliktin e interesit dhe ruajtur sekretin profesional, në interes të drejtësisë penale dhe rritjes së besimit të publikut tek organi i prokurorisë. Kodi i etikës synon të informojë qytetarët për standardet e sjelljes dhe shërbimet që kanë të drejtë të presin nga këta punonjës.
- Udhëzim nr 33, datë 31.12.2018 “Për komunikimin publik dhe bashkëpunimin ndërinstitucional”. Qëllimi i këtij udhëzimi është rregullimi i mënyrës së komunikimit me publikun, median për aktivitetin dhe punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër merr të gjitha masat për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Ky udhëzim synon të arrijë, lehtësimin e komunikimit ndërmjet organit të prokurorisë dhe publikut, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë dhe publikut, informimin dhe vetëdijesimin e publikut mbi rolin, kompetencat dhe veprimtarinë e prokurorisë, promovimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes e publikut në parandalimin e krimin, dhe në procesin e reformave në të cilat përfshihet prokuroria, si dhe forcimin e llogaridhënies publike të prokurorisë duke ruajtur integritetin, pavarësisë dhe paansinë. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër realizohet nga zyra për marrëdhëniet me publikun (në vijim zyra). Janë përcaktuar detyrat

e koordinatorit, punonësit të shërbimit, prokurorit për median, prokurorit të çeshtjes, si dhe është rregulluar mënyra e koordinimit të tyre me drejtuesin e prokurorisë për rastet e konkrete.

Është krijuar për herë të parë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër programi i transparencës.

- Drejtuesi i prokurorisë, në bazë të udhëzimit nr. 03, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çeshtjeve në prokurori”, i nxjerrë në mbështetje të nenit 148/b, shkronja ‘b’ e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 53 të ligjit nr 97/2016 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë’, ka hartuar dhe miratuar formularët përkatës për të garantuar dhe respektuar shortin elektronik dhe manual. Me anë të këtyre formularëve i përcjelllet kërkesa kryesekretarës, për realizimin e shortit elektronik, e cila duhet të njoftojë paraprakisht prokurorët, prokurorin e regjistrit dhe drejtuesin e seksionit përkatës për orarin e zhvillimit të tij. Dokumentimi i prezencës së prokurorëve realizohet nëpërmjet procesverbalit të përpiluar nga drejtuesi i seksionit dhe të nënshkruar nga ata.
- Drejtuesi i prokurorisë me urdhërin nr 06 datë 11.07.2018 “Për verifikimin e ecurisë të çeshtjeve gjatë hetimeve paraprake”, ka urdhëruar verifikimin e ecurisë së hetimeve të procedimeve penale të regjistruara në vitet 2017 (para datës 01.06.2017), 2016, 2015, 2014, 2013 dhe të papërfunduara (në hetim e sipër nga prokurorët), si dhe verifikimin e ecurisë së hetimeve të procedimeve penale të papërfunduara, që janë të regjistruara në gjashtë mujorin e parë të vitit 2018 në kuadër të cilëve janë caktuar masa sigurimi ndaj personave nën hetim. Verifikimi është të kryer nga drejtuesit e seksioneve brenda datës 25.07.2018 dhe në përfundim të verifikimit është informuar drejtuesi i prokurorisë.
- Drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë urdhërin Nr. 15 datë 06.09.2018, me anë të cilit ka urdhëruar krijimin e grupit të punës me objekt veprimtarie çeljen e zyrës së prokurorës Marsida Frashëri dhe inventarizimin e materialeve që gjenden në zyrën e saj. Në bazë të këtij urdhëri grupi i punës me datë 14.09.2018 ka hapur zyrën e prokurorës Znj. Marsida Frashëri dhe në të ka konstatuar materiale shpresore. Nga kqyrja e tyre, ndër të tjera, rezultoi se kishte edhe një numër të konsiderueshëm materialesh të kallëzimeve penale, si dhe fashikuj procedimesh penale të periudhës 2010 - 2017, për të cilat nuk ka ushtruar ndjekjen penale duke mos kryer asnjë veprim hetimor dhe nuk ka marrë vendimmarrje. Në përfundim të inventarizimit është përpiluar procesvebali përkatës. Informacioni i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, për verifikimin e rastit.

XVII. ADMINISTRIMI I TEKNOLOGJISE DHE INFORMACIONIT NE PROKURORI

Gjatë vitit 2018, janë për t'u theksuar disa mangësi që hasim në punë dhe që janë domosdoshmëri për një efijencë sa më të lartë:

- paisja e te gjithë prokurorëve dhe oficereve te policise gjyqesore ne prokurori, me kompjutera me parametra te larte teknike.
- Pajisja me printera zyre. Gjithashtu eshte per t'u theksuar se mospasja e printerave ne zyre, shkakton vonese te pajustificuar ne kryerjen e veprimeve dhe gjithashtu ekspozohet materiali i hetimit.
- Printer rrjeti me kapacitet te larte.

Ndërkohë sistemi i menaxhimit të çështjeve, nuk është përdorur nga prokurorët dhe opgj-të duke mos bërë të mundur vënien në zbatim të kësaj risie në organizimin e punës së prokurorisë. **Gjithashtu konstatohet se sistemi CAMS nuk është plotësuar nga punonjësi i ngarkuar. Për këto shkelje ndaj tij është marrë masa e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.**

XVIII. RAPORTI FINANCIAR

Në vitin 2018:

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër gjatë vitit 2018 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike – financiare janë çelur fondet:

Fondi	Plan	Fakt	Realizimi
Fondi i Pagave 600	48.363.220	48.362.362	100%
Fondi i sigurimeve Shoq.Shëndt.	7.099.000	7.009715	98.7%
Fondi i shpenzimeve materiale	11.046.000	11.045.899	100%
Fondi transf. buxhetete familjare e indiv.	50.000	50.000	100%

Realizimi i fondeve është në masën 99.7%.

Shpenzime procedurale dhe te ardhura nga fotokopjet të arkëtuara nga Prokuroria jonë janë **826.345 lekë** të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit.

Ndërkohë te hyra mjete ne ruajtje nga procedimet penale kanë qenë **5.478.521** lekë.

Totali i pageses se oreve te gatishmërisë për prokurorët është në shumën prej **3.464.403** leke.

Totali i pageses te mbikohës te punes për prokurorët është **554.558** lekë.

Në vitin 2017:

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër gjatë vitit 2017 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike – financiare janë çelur fondet:

Fondi	Plan	Fakt	Realizimi
Fondi i Pagave 600	46.035.000	45.786.678	99.5%
Fondi i sigurimeve Shoq.Shëndt.	7.040.000	6.616.878	94%
Fondi i shpenzimeve materiale	11.376.110	11.376.097	100%

Realizimi i fondeve është në masën 97.8 %.

Shpenzime procedurale dhe te ardhura nga fotokopjet të arkëtuara nga Prokuroria janë **152.100** leke të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit.

Ndërkohë te hyra mjete ne ruajtje nga procedimet penale kanë qenë **18.900** lekë.

Totali i pageses se oreve te gatishmërisë për prokurorët është në shumën prej **2.978.048** leke.

Totali i pageses te mbikohës te punes për prokurorët **78.860** lekë, për oficerët e policisë gjyqësore **0** lekë.

XIX. ÇËSHTJE TË TJERA ME RËNDËSI

A. Bashkëpunimi me policinë gjyqësore

Rreth 51% e procedimeve penale për vitin 2018 është hetuar nga shërbimet policore në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, ndërsa 49 % nga policia gjyqësore në seksionin pranë prokurorisë. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë janë konstatuar marrëdhënie korrekte dhe efektive bashkëpunimi si me Drejtorinë e Policisë Vendore Shkodër , me komisaritetet përkatëse ashtu edhe me policinë gjyqësore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në këtë bashkëpunim, kanë ndikuar takimet e përbashkëta, analizat ku janë evidentuar problemet që hasen si zvarritja e hetimit, problematikat për çështje specifike, paqëndrueshmëria e oficerëve të policisë gjyqësore në detyrë për shkak të transferimeve. Shumë prej oficerëve të policisë

gjyqësore nuk gëzojnë stabilitet në vendin ku ushtrojnë funksionet, pasi transferohen nga njëri seksion tek tjetri, nga njëri rreth tek tjetri, gje që ndikon drejtpërsëdrejti në zvarritjen e hetimeve.

Oficeret e policisë gjyqësore në seksionet pranë prokurorisë janë thirrur dhe kanë qënë prezent në mbledhjen e prokurorëve, kur janë diskutuar ceshtje që i përkasin hetimit, apo veprimtarisë së tyre.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre janë konstatuar disa problematika. Në përfundim të veprimeve hetimore të kryera, ata nuk përpilojnë relacionet përkatëse, apo edhe në ato raste kur përpilohen paraqesin mëngësi, që lidhen me bazën ligjore, argumentimin, analizimin e elementëve të veprave penale për të cilat bëhet edhe sugjerimi përkatës apo bëjnë sygjerime ne kundërshtim me çfarë ka rezultuar nga provat.

Gjithashtu aktet procedurale që përpilojnë oficeret e policisë gjyqësore shfaqin mangësisë në drejtim të respektimit të rregullave të drejtshkrimit dhe nuk përdorin karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit.

Vlen te theksohet se marrëdhëniet e prokurorisë me drejtuesit e Drejtorisë Policisë së Qarkut Shkodër dhe Komisarivateve që ajo mbulon, janë në një frymë bashkepunimi dhe ndihme, në funksion të rritjes së cilësisë dhe shpejtësisë në hetim. Janë organizuar edhe takime pune që ndikojnë në përmirësimin e punës.

B. Komisioni disiplinor

Në Prokurorinë pranë Gjyaktës së Shkallës së Parë Shkodër është ngritur Komisioni Disiplinor. Për vitin 2018 ky komision nuk ka shqyrtuar ndonjë rast të shkeljeve disiplinore. Pavarësisht zvarritjeve të pajustificuara, prokurorët nuk kanë paraqitur relacion për shkeljet e kryera nga policia gjyqësore. Drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë urdherin nr.32 datë 31.12.2018 “Për administrimin e materialeve të kallëzimeve dhe të fashikujve të procedimeve penale”. Në këtë urdher me qëllim evidentimin e ngarkesës së secilit officer është parashikuar rregulli që terheqja e dosjeve nga ana e oficerëve të bëhet në kryesekretari kundrejt nënshkrimit. Gjithashtu drejtuesi i prokurorisë ka urdher verifikimin e ecurisë së kryerjes së detyrave të ngarkuara nga oficeret e policisë gjyqësore. Në përfundim të verifikimit do të përpilohet informacioni përkatës dhe nëse gjëndet me vend do të iniciohen procedurat disiplinore.

C. Bashkëpunimi me prokuroritë e tjera

Marrëdhëniet ndërmjet Prokurorisë janë domosdoshmërisht të nevojshme pasi i shërbejnë më së miri zgjidhjes së problematikës së hasur në punën e përditshme, duke kërkuar zgjidhje ligjrisht dhe bashkëpunimit me prokuroritë e rrethëve të tjera gjyqësore në koordinimin e hetimeve dhe dhënien e informacioneve që mund të nevojiten.

Përsa i përket Prokurorisë së Apelit Shkodër kemi pasur kontakte të herëpashershme dhe kjo i ka shërbyer punës në lidhje me kualifikimin, vendimmarrjen, për të dhënë një zgjidhje sa më të drejtë dhe ligjore për rastet. Janë ndjekur me kujdes të veçantë mënyra e përfundimit të çështjeve të cilat ankimuar si nga të pandehurit ashtu edhe nga ana jonë.

D. Bashkëpunimi me Gjyqësorin

Për vitin 2018 bashkëpunimi me gjykatën ka qënë efektiv. Gjyqtarët kane qene të gatshem dhe të disponueshem ne çdo kohe per kerkesat e prokuroreve ne fazen e hetimeve paraprake, kerkesa qe kane te bejne me vleftesimin e masave te sigurimit, per lejimin e veprimeve te pergjimit, sigurimin e provave, kontrollet e banesave etj. Për zgjidhjet që janë vlerësuar në kundërshtim me kërkesat e prokurorëve është ndjekur rregullisht rruga ligjore, pra ankimimi.

XX. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2019

Në përcaktimin objektivave të saj, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, merr në konsideratë në veçanti gjetjet (mangësitë) e konstatuara në këtë raport lidhur me veprimtarinë e institucionit tonë, si dhe strategjinë e Prokurorisë 2018-2020 dhe planin e saj i veprimit, pa përjashtuar plotësimin e rekomandimeve eventuale të Bashkimit European dhe të Këshillit të Ministrave për vitin 2019, apo kërkesat eventuale të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të Prokurorisë për vitin 2018”.

Përsa më sipër objektivat për vitin 2019 do të jenë:

1. Rritja e cilësisë dhe efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër duhet të ketë si objektiv kryesor rritjen e cilësinë dhe efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale. Në këtë aspekt rëndësi themelore merr barazia e shtetasve para ligjit dhe garancia e realizimit të drejtave dhe të lirive të garantuara nga aktet të brendshme juridike të shtetit tonë, si dhe nga standardet ndërkombëtare, të cilat përbëjnë vlerën më të lartë të shtetit të së drejtës. Prandaj vënia përpara përgjegjësisë penale e kujtdo që shkel ligjin, është esenciale.

Përmbushja e këtij objektiv mund të arrihet nëpërmjet realizimit të masave të mëposhtme:

1. *Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional.* Në luftën kundër kriminalitetit bashkëpunimi dhe koordinimi është thelbësor në ngritjen e një çështje penale. Për këtë arsye forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional është prioritar. Shkëmbimi i shpejtë i informacionit dhe përdorimi e metodave të posaçme hetimore mbetet një element detërminant për suksesin në një çështje penale. Për të kuptuar qasjen institucionale është e nevojshme që në

mënyre periodike të realizohen takime dhe analiza të përbashkëta me Policinë e Shtetit, apo me atë gjyqësore, si dhe institucionet e tjera ligjzbatuese. Duhe të organizohen trajnime të përbashkëta me policinë gjyqësore me synim përmirësimin e funksionimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe në policitë gjyqësore të institucioneve të tjera. Pavarësisht rritjes së aksesit të prokurorisë në bazat e të dhënave të institucioneve shtetërore, është e nevojshme që aksesit të jetë permanent dhe sa më i gjërë i mundshëm.

2. *Rritja e cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore.* Ushtrimi i ndjekjes penale duhet të jetë i plotë dhe gjithpërfshirës. Në këtë drejtim merr rëndësi përmirësimi i njohurive nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore me anë të trajnimeve të ndryshme, përmirësimi i strategjisë dhe planeve të hetimit, si dhe përmirësimi i cilësisë së akteve procedurale.
3. *Rritja e cilësisë së hetimit pasuror.* Do të synojmë rezultate më të larta nëpërmjet hetimit pasuror, i cili në zbatim të ligjit nr. 10192/2009, të përmirësuar nga ndryshimet e vitit 2017, i ka kaluar në kompetencë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Zhvillimi i hetimeve financiare paralelisht me çdo hetim për vepra penale të rënda, falsifikimin, për vepra penale që lidhen me detyrën, apo ato nga të cilat gjenerojnë të ardhura, si dhe rritja e hetimeve proaktive. Shfrytëzimi i teknologjisë dhe kapaciteteve hetimore-financiare të institucioneve si tatime, dogana, banka etj; Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. Rritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme.
4. *Përdorimi me efikasitet të përgjimeve të komunikimeve elektronike.* Ka qenë një objektiv i vazhdueshëm i prokurorisë realizimi i veprimeve teknike të përgjimit nga oficerët e policisë gjyqësore nën drejtimin dhe kontrollin e prokurorit që heton, duke vlerësuar si një pikë të fortë në rritjen e efikasitetit të hetimit, mundësinë e ndjekjes në dinamikë të përgjimit dhe nga ana tjetër ngushtimin e rrethit të subjekteve që marrin informacion. Ndryshimet ligjore të vitit 2017, i hapën rrugën këtij procesi dhe hapat e mëtejshëm synojnë, krijimin dhe funksionimin i strukturave të posaçme dhe të specializuara për kryerjen e përgjimit të komunikimeve elektronike pranë prokurorive, pajisja e strukturave të mësipërme me mjetet teknike të nevojshme dhe trajnimi për përdorimin. Zgjerimi i kapaciteteve për përgjimin aktiv.
5. *Forcimi i luftës ndaj krimit kibernetik.* Krimi kompjuterik dhe provat elektronike (dixhitale) kërkojnë një reagim të specializuar nga autoritetet e drejtësisë penale. Organet e zbatimit të ligjit dhe prokuroritë duhet të jenë të afta të hetojnë dhe të ndjekin penalisht veprat penale kundër të dhënave dhe sistemeve kompjuterike, veprat penale me anë të kompjuterëve si dhe provat elektronike në lidhje me krimet. Në këtë drejtim synohet trajnimi i përshtatshëm i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, njohja me legjislacionin ndërkombëtar, shkëmbimi i eksperiencave më të mira ndërkombëtare të

hetimit të krimeve kompjuterike. Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e tjera shtetërore dhe ato private të cilat operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit.

6. *Forcimi i luftës ndaj veprave penale, të pastrimit të parave*, ushtrimit të veprimtarisë financiare të palicensuara, narkotikeve dhe specifikisht edhe veprat penale me te evidentuara ne qarkun ku kjo prokurori shtrin funksionin si ato në sferen ekonomike dhe kunder pasurise etj. Sidiqoftë lufta ndaj kriminalitetit nuk kryhet vetem por me bashkepunimin dhe pjesmarrjen e gjithë hallkave dhe strukturave te shtetit si dhe te vete shtetasve.
7. *Kryerja e analizave dhe studimeve për ecurinë e punës* në drejtim të goditjes së formave të ndryshme të kriminalitetit, efektivitetit të hetimit, politikës penale, ngarkesës së prokurorive dhe prokurorëve, përcaktimit të nevojave materialo-financiare për strukturat që operojnë në këtë drejtim dhe plotësimin e tyre.

2. Forcimi i integritetit dhe garantimi i pavarësisë së prokurorit

Për vitin 2019 do të jetë në focus forcimi i integritetit të prokurorit dhe garantimin e pavarësisë së tij, duke siguruar nga ana tjetër llogaridhënien e në përputhje me ligjin të për veprimtarinë e prokurorit. Në këtë drejtim do të realizojmë objektivin përmes masave si vijon:

- Garantimi i ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve;
- Bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procesin e vlerësimit profesional dhe hetimin disiplinor të prokurorëve;

3. Respektimi i të drejtave të njeriut

Ky objektivi do të arrihet përmes masave të renditura më poshtë, bazuar në njohjen e thellë dhe zbatimin e legjislacionit vendas, EU acquis dhe standardeve ndërkombëtare:

1. Bashkëpunim me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë për të kuptuar dhe adresuar shkaqet rrënjësore të krimit, dhe për të mbështetur ndërhyrjet efektive;
2. Mbrojtja e viktimave të krimit si dhe parandalimi i ri-viktimizimit të tyre;
3. Sigurimi i aksesit në drejtësi për njerëzit vulnerabël dhe të marginalizuar;
4. Trajtimi me dinjitet, drejtësi, dhe barazi të të gjithë subjekteve në proces;
5. Garantimi i shërbimeve të nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm në çdo prokurori;
6. Analiza periodike mbi afatet e hetimit dhe politikën penale në çështjet me të mitur apo subjektet e tjera me status të veçantë;
7. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të prokurorisë mbi ndryshimet ligjore lidhur me procesin ndaj të miturve në konflikt me ligjin dhe rolin e viktimës në procesin penal.

4. Forcimi i besimit të publikut në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër

Është detyrim i prokurorisë të garantojë të drejtën e informimit të publikut në lidhje me veprimtarinë e saj, brenda kufijve të vendosur nga ligji procedural penal. Nga ana tjetër prokuroria e sheh komunikimin me publikun si një mundësi për rritur besimin në sistemin e prokurorisë, si një mundësi që publiku të njohë punën e prokurorisë në mbrojtjen e të drejtave të tij e për pasojë të nxitë denoncimin e krimit.

DREJTUESI I PROKURORISË

YLLI PJETËRNIKAJ